



**Prishtinë, 20 shkurt 2015**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_696\_2015**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-492-2012 dt. 28 dhjetor 2012 për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë "Drini i Bardhë" SH.A., në Lumin Drini i Bardhë, HC Dobrushtë në lokacionin e fshatit Dobrushtë me kapacitet të instaluar prej 9.96 MW, komuna e Prizrenit, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për HC Dobrushtë në lokacionin e fshatit Dobrushtë, me kapacitet të instaluar prej 9.96 MW, komuna e Prizrenit, të datës 29.01.2015 të shoqërisë "Drini i Bardhë" SH.A., me adresë: rruga "Vetim Shala" nr. 4, KK Prizren, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Drini i Bardhë" SH.A., dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Dobrushtë në lokacionin e fshatit Dobrushtë, me kapacitet të instaluar prej 9.96 MW, komuna e Prizrenit.
- II.** Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
- III.** Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.





## Arsyetim


- ZRRE me datë 03.02.2015 nga shoqëria “Drini i Bardhë” SH.A., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Dobrushtë në lokacionin e fshatit Dobrushtë, me kapacitet të instaluar prej 9.96 MW, komuna e Prizrenit.
  - Bordi i ZRRE-së me datë dt. 28 dhjetor 2012, shoqërisë “Drini i Bardhë” SH.A., i ka lëshuar Vendimin V-492-2012 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
  - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit . V-492-2012 dt. 28 dhjetor 2012 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën i është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, shoqërisë “Drini i Bardhë” SH.A., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

### Bordi i ZRRE

  
Enver Halimi, kryesues

  
Merita Kostari, anëtare

  
Krenar Bujupi, anëtar